FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

FGJK - KGF

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

RAPORT - KAMPIONATI BALLKANIK I GJIMNASTIKES ARTISTIKE - 2025

1. Përmbledhje

Federata e Gjimnastikës së Kosovës, në bazë të kalendarit të saj të garave, mori pjesë në Kampionatin Ballkanik të Gjimnastikës Artistike për grupmosha (WAG), të mbajtur në Zadar të Kroacisë. Ky ishte edicioni i katërt i këtij kampionati, ndërsa Kosova ka marr pjesë në cdo edicion, pra kjo ishte hera e katërt që FGJK merr pjesë në Kampionatin Ballkanik të Gjimnastikës.
Delegacioni i Kosovës përbëhej nga gjimnastet e tre kategorive Pre-Youth apo fëmijë, Youth apo të reja dhe Juniore, stafi teknik dhe përfaqësuesit zyrtarë të Federatës.

Garat u zhvilluan në:
Sports Center Višnjik – Kresimir Cosic Hall,
Splitska 3, 23000 Zadar, Kroaci.
Veglat zyrtare ishin të prodhuesit **SPIETH**.
Data zyrtare: 2 - 6 nëntor 2025
Salla e garës, pamja nga jasht:



2. Përbërja e ekipit

Gjimnastet:
Pre-Youth: Hira Haziri, Borë Krasniqi, Hira Elshani
Youth: Fernaze Cakaj, Djellona Azemi, Jora Gërvalla
Junior: Sara Pllana, Bora Hoti, Rea Berisha

Shtabi Teknik:
Shef i delegacionit: Besnik Latifi
Kryetari i FGJK-së: Shkumbin Maqastena
Trajnerë: Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu, Arlind Shaqiri
Mjeke: Dr. Blerina Mema

Sipas rregullave të garës ekipi duhet të ketë në maksimum 9 gjimnaste garuese, por vetem 6 nga to garojnë për ekip ndëra tri të tjera garojnë vetëm në garën individuale. Gjimnastet që garuan në individuale ishin Hira Elshani, Jora Gërvalla dhe Rea Berisha.

3. Udhëtimi dhe akomodimi

Nisja nga Kosova u bë më 01.11.2025, ora 22:00, nga parkingu prapa Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Udhëtimi u realizua me autobus, kompania Beni Reisen.
Mbërritja në Zadar u bë më 02.11.2025, ora 12:00. Pas mbërritjes, ekipi shkoj për drekë dhe në ora 14:00 u krye regjistrimi në hotelin zyrtar të garës Hotel Kolovare.Organizatorët kishin siguruar linja të rregullta transporti çdo orë ndërmjet hotelit dhe sallës së garës.
Gjimnastet u akomoduan në dhoma dhe pushuan disa orë.
Organizatorët kishin siguruar linja të rregullta transporti çdo orë ndërmjet hotelit dhe sallës së garës.
Kthimi në Kosovë u bë prap me autobus, duke u nisur me date 07 nëntor, e premte nga ora 11:00, dhe pas 14 orë udhëtim ekipi mbërriti në Prishtinë.

4. Stërvitjet

Me datë **02 nëntor**, në mbrëmje nga ora 17 deri ne ora 20:00 u mbajt seanca e parë stërvitore. Kjo kohë ishte e rezervuar për trajnim të lirë. Këtu ushtruan të gjitha gjimnastet e Kosovës dhe e pane për herë të parë sallen e garave,
Me date **03 nëntor** ishte stërvitja zyrtare sipas orari të caktuar nga organizatorët. 16:00 – 18:00: WAG Training – Subdivision 1 & 2 (Kosova në Subdivision-in e caktuar nga shorti).
Ekipi i Kosovës u sigurua që gjimnastet dhe pjesa tjetër e stafit të ushqehen 2 orë para trajnimeve. Vendodhja e shujtave ditore ishte në Hotel Kolovare.

5. Ecuria e ditës së parë të garës – kualifikimet.

Me datë **04 nëntor** ishte dita e parë e garës.
Në mëngjes me fillim nga ora 09:00 Kryetari i FGJK-se Shkumbin Maqastena bashk me Arlind Shaqirini ishin te ftuar nga Federata Kroate për një shëtitje dhe diskutime pune. Për 4 orë me anije së bashku me kryetarët e federatave të tjera, u shëtiten me anije afër ishujve përrreth. Ndër shumë qështje që u diskutuan, kryetari i FGJK, ju shpalosi të gjithve dëshirën që Kosova ta organizon kampionatin ballkanik në një të ardhme të afërt.
Takim mes Federatave kishte edhe në mbrëmje ku edhe u darkua së bashku.

Pjesa tjetër e ekipit pushoj mire gjatë ditës, duke ngrënë mëngjesin në ora 09:00, dreken në ora 13:30, ndërsa në ora 14:30 u nisën të gjithë së bashku me autobus për në sallen e garës. Aty pas kryres se nxemjeve gjenerale, gjimnastet ushtruan ne katër veglat nga dhjetë minuta. Ndërsa në ora 16:00 filluan parakalimet e gjimnasteve.
Kosova filloj garën në disiplinen parter, dhe me rotacion në formë olimpike pastaj garuan edhe në tre veglat tjera.

Rezultatet nga kualifikimet:

		Kualifikiimet				
Emri dhe mbiemri	Grupmosha	Kapërcime	Paralele	Tra	Parter	TOTALI (4-garësh)
Hira Haziri	Pre-youth	10.150	8.600	8.850	10.200	**37.800**
Borë Krasniqi	Pre-youth	10.250	6.500	9.150	9.650	**35.550**
Hira Elshani	Pre-youth	10.250	.	.	7.050	**17.300**
Djellona Azemi	Youth	10.750	7.000	4.450	7.450	**29.650**
Fernaze Cakaj	Youth	11.400	9.150	11.000	10.250	**41.800**
Jora Gërvalla	Youth	11.025	.	.	9.500	**20.525**
Sara Pllana	Junior	11.900	7.900	11.800	11.900	**43.500**
Bora Hoti	Junior	11.850	8.850	9.100	10.300	**40.100**
Rea Berisha	Junior	.	.	.	.	**-**

Vendi i shtatë në ekipore me 124.550 pikë.

FGJK arriti ti sgiuroj 2 finale me gjimansten Sara Pllana në veglat tra dhe parter. Në tra në kualifikime Sara u rëndit e para, ndërsa në parter e treta, duke na dhënë shumë shpresa për finale. Kjo finale poashtu shënon herën e parë që një gjimnaste nga FGJK arrin të kualifikohet për finale në ballkanik.

5. Rezultatet – Finalja

Finalja u zhvillua të nesërmen me datë 06 Nëntor me fillim nga ora 15:00. Sara bashk me trajnerët e saj dhe me pjesën tjetër të ekipit që ishin aty për ta përkrahur, erdhen nga ora 14:00 në sallen e garave.
Finalja filloj në tra ku Sara arriti të rënditet e treta. Pas kryerjes së kësaj disipline i tërë ekipi u gëzua shumë për këtë rezultat historik.
Pastaj Sara Pllan garoj në parter ku u rëndit e pesta.

Kjo medalje shënon medaljen e parë ballkanike në historinë e gjimnastikës kosovare.
Në ceremoninë e ndarjes së medaljeve, Kryetari i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, z. Shkumbin Maqastena, ndau medaljet në dy kategori, përfshirë edhe atë ku fitoi Sara Pllana.

Në mbrëmje u mbajt banketi përfundimtar. Mbrëmjen ekipi ynë e shfrytëzoj për një shëtitje në Zadar të gjithë së bashku.

Informatë shtesë:
Gjatë kthimit për në Kosovë, autobusi realizoi një ndalesë të shkurtër në Malin e Zi, ku anëtarët e delegacionit blenë ushqime në Burger King. Pas ushqimit, një person i panjohur, i cili dyshohej se ishte nën ndikimin e alkoolit, filloi të ngrinte zërin në drejtim të ekipit, duke pasur tendencë të vërsulet, duke pretenduar se autobusi ishte parkuar gabim. Situata u menaxhua me qetësi nga stafi i Federatës dhe nuk pati asnjë incident apo përplasje fizike.

6. Përfundim

Pjesëmarrja e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës në Kampionatin Ballkanik 2025 u vlerësua si e suksesshme dhe historike.
Kosova realizoi debutimin e saj në këtë ngjarje zyrtare dhe arriti **medaljen e parë ballkanike**, përmes gjimnastës **Sara Pllana**, në veglën Tra.

Delegacioni i Kosovës u paraqit në mënyrë profesionale dhe respektoi të gjitha kërkesat organizative të ngjarjes.
Ky rezultat konsiderohet një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të mëtejshëm të gjimnastikës kosovare dhe rritjes së konkurrueshmërisë në arenën ndërkombëtare.

Rezultatet e plota të garës mund të gjenden në linkun:
https://fgjk-kos.com/garat-nderkombetare/

Foto nga gara

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td></td>
<td>
</td>
</tr>
<tr>
<td>
</td>
<td></td>
</tr>
</table>

	

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

FGJK - KGF

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

Data e raportit: 18 Nëntor 2025